

UDHËZUESI PËR APLIKIM

Bursa për Gazetari në fushën e të Drejtave të Njeriut.

2019



Projekt i financuar nga BE-ja
dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit
European në Kosovë.

Implementuar nga:

KO
SO
VO
2.0



THE GOVERNMENT
OF THE GRAND DUCHY OF LUXEMBOURG

Ky Program bashkëfinancohet nga projekti 'Mbështetja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë'

financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Përmbajtja

- I. Sfondi
- II. Kërkesat dhe pritshmëritë e programit
- III. Kushtet e pranimit
- IV. Dorëzimi i paketës së aplikimit
- V. Vlerësimi
- VI. Si të aplikohet

I. SFONDI

Kosovo 2.0 në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore dhe Qendrën për Barazi dhe Liri (CEL) kanë kënaqësinë të lansojnë thirrjen e hapur për ciklin e dytë të Programit të bursave për gazetari në fushën e të drejtave të njeriut. Ky program është pjesë e projektit tre-vjeçar: “Mbështetja e mediave dhe gazetarisë së pavarur me perspektivë të të drejtave të njeriut në Kosovë” - program që realizohet me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në Kosovë dhe bashkëfinancohet nga projekti ‘Mbështetja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë’ financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Programi angazhon dhe fuqizon gazetarët e rinj që t’u shërbejnë interesave të të heshturve, të marginalizuarve, të ndarëve e shpeshherë të përjashtuarve. Ky program, përmes gazetarisë sjellë në diskursin publik qasje e këndvështrime që kundërshtojnë normat tradicionale dhe diskriminuese dhe që i vendosin grupet e shoqërisë në rrezik.

Gazetarë të rinj mbështeten financiarisht dhe përmes mentorimit të vazhdueshëm të redaktorëve të përzgjedhur e me përvojë në fushën e të drejtave të njeriut që të prodhojnë një artikull të shkruar, video, ese fotografike me perspektivë të të drejtave të njeriut. Përgjatë 6 muajve përfituesit e bursës punojnë për së afërmi me redaktorët, zhvillojnë hulumtim rreth temave të tyre, identifikojnë hisedarë relevantë, intervistojnë burime të ndryshme dhe në fund përfundojnë produksionin e tyre, i cili në fund publikohet në revistën online të Kosovo 2.0.



Projekt i financuar nga BE-ja
dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit
Europian në Kosovë.

Implementuar nga:



THE GOVERNMENT
OF THE GRAND DUCHY OF LUXEMBOURG

Ky Program bashkëfinancohet nga projekti ‘Mbështetja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë’

financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Përmes këtij programi, këtë vit 11 gazetarë/e të rinj/reja do të marrin pjesë në trajnime dhe mentorim, me qëllim që të bëhen pjesë dhe të udhëheqin gjeneratën e re të gazetarisë në Kosovë. Specifikisht, ata do të pranojnë mbështetje me qëllim që të punojnë produksione të kualitetit të lartë, inovative e kreative me perspektivë të drejtave të njeriut dhe produksione që kanë potencial të arrijnë tek një audiencë më e gjerë.

II. KËRKESAT DHE PRITSHMËRITË E PROGRAMIT

Programi HRJF 2019 do të fillojë në maj 2019 dhe do të përfundojë në nëntor 2019. Përfituesit do të përzgjedhen në bazë të cilësisë dhe potencialit të aplikacioneve të paraqitura. Programi i bursave është dizajnuar për gazetarë të rinj nga Kosova, të cilët janë të përkushtuar në prodhime gazetareske me fokus në të drejtat e njeriut në Kosovë. 11 përfitues/e do të përzgjedhen këtë vit për përpjesëmarrje në këtë program.

Gjatë periudhës së implementimit, nga përfituesit e përzgjedhur pritet të prodhojnë një storie (me analizë) të thellë, në njërin nga formatet e mëposhtme.

- Format shkrimi/artikulli (3000 deri në 5000 fjalë)
- Video (10 deri në 20 minuta)
- Format multimedial (duke përfshirë tekst dhe një ose më shumë elemente audiovizuale)
- Ese fotografike

Ju lutem të keni parasysh që gjatë këtij cikli të programit, Kosovo 2.0 inkurajon fuqishëm aplikacionet që paraqesin formate të ndryshme multimediale.

Çdo përfitues/e i/e programit:

- Do të përfitojë mbështetje financiare prej 2.500 eurove për të prodhuar një storie në njërin nga formatet e sipërpërmendura.
- Do të angazhohet në trajnimet e organizuara në fillim të programit në prodhimin e storieve, standardet etike dhe të gazetarisë, dhe në fushën e legjislacionit të drejtave të njeriut në Kosovë.



Projekt i financuar nga BE-ja
dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit
European në Kosovë.

Implementuar nga:



Ky Program bashkëfinancohet nga projekti 'Mbështetja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë'

financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

- Do të punojë nën mbikëqyrjen e redaktorit.

Aplikantët duhet të dorëzojnë projektpropozime në përputhje me objektivat në vijim:

O1: Propozimet duhet të adresojnë çështje që lidhen në mënyrë direkte me të drejtat e njeriut, respektivisht barazinë gjinore, orientimin seksual, të drejtat e komuniteteve LGBTIQ+, të drejtat e të rinjve, të drejtat e komuniteteve jo-shumicë, të drejtat qytetare. Ndonjë çështje specifike ose temë që prek individë nga grupet e tilla të rrezikuara duhet të specifikohet qartë në propozim.

O2: Propozimet mund të adresojnë çështje kulturore, artistike ose çështje në thelb politike; por, ato duhet të karakterizohen me qasje të ndjeshme dhe të fokusohen në të drejtat e njeriut.

Aplikantët në aplikacionin e tyre duhet të përfshijnë:

- Përshkrimin e çështjes që do të trajtohet
- Relevancën dhe rëndësinë për grupin në rrezik ose shoqërinë në përgjithësi.
- Subjektet dhe akterët që do të intervistohen; dhe burimet preliminare
- Ndikimi social potencial ose/dhe i pritshëm që do të shpërndahe.
- Grupet e synuara/audienca
- Kanalet përmes së cilave do të arrihet kjo audiencë
- Buxhet preliminar

Projektpropozimet dhe gjuhët e përdorura gjatë gjithëprogramit mbështetës janë shqip, serbisht dhe/ose anglisht. Propozimet duhet të adresojnë çështje brenda Kosovës, dhe prioritet do t'u jepet çështjeve të cilat fokusohen në nivelin lokal. Projektpropozimet duhet të kenë kohëzgjatje prej 6 muajve. Aplikimet me kohëzgjatje më të shkurtë ose më të gjatë nuk do të pranohen.

Në rast të përzgjedhjes, pritet që individët të marrin pjesë në të gjitha segmentet e programit të përmendura më lart, dhe t'i përmbushin rezultatet në vijim. Programi dhe aktivitetet e programit nuk mund të shtyhen.

Vërejtje: Mospërfundimi i suksesshëm i detyrave dhe përgjegjësive të parapara në kuadër bursës për gazetari në fushën e të drejtave të njeriut do të rezultojë në shkëputje të kontratës dhe ndërprerje të pagesës.



Projekt i financuar nga BE-ja
dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit
European në Kosovë.

Implementuar nga:



THE GOVERNMENT
OF THE GRAND DUCHY OF LUXEMBOURG

Ky Program bashkëfinancohet nga projekti 'Mbështetja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë'

financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

III. KUSHTET E PRANIMIT

Ky program synon gazetarë të rinj, të pavarur ose freelance, të punësuar dhe/ose të papunësuar. Ju lutem t'i rishikoni kushtet e pranimi për këtë program:

1. Gazetarë të rinj, të pavarur ose freelance, të punësuar dhe/ose të papunësuar.
2. Persona të lindur (dhe që jetojnë) në Kosovë.
3. Të moshës 18 deri 35 vjeç më 24.03.2019.
4. Së paku një vjet përvojë profesionale dhe/ose dy vite i/e arsimuar në gazetari dhe/ose në komunikim.
5. Aplikuesit që janë aktualisht të punësuar duhet të kenë mundësi t'i kushtojnë kohë Programit në aspektin e trajnimit, takimeve me redaktorë dhe kështu me radhë. Paraprakisht duhet të sigurohet një letër e pëlqimit/mbështetjes nga punëdhënësi i aplikuesit duke shprehur gatishmëri për ta lejuar aplikuesin të marrë pjesë në këtë Program.
6. Përfituesit e bursës së ciklit të parë mund të aplikojnë, megjithkëtë prioritet do t'u ipet kandidatëve të rinj.

IV. DORËZIMI I PAKETËS SË APLIKIMIT

Paraqitja e propozimit të projektit duhet t'i referohet "trajtimit të çështjeve njerëzore" (shiku KUSHTET DHE PRITSHMËRITË E PROGRAMIT) dhe të dëshmohet qasje origjinale e hulumtimit dhe aspektet e raportimit/prodhimit të temës.

Aplikuesit duhet:

7. Të mbushin formularin e aplikimit.
8. T'i bashkëlidhin dokumentet e tjera të kërkuara, të përfshira në formularin e aplikimit, siç janë informatat për shkollimin, aftësitë profesionale, letra e pëlqimit nga punëdhënësi aktual dhe ambiciet e karrierës, shembuj të punës së mëparshme (nëse ka)

Pyetjet në lidhje me detajet e Programit ose rreth përgatitjes së dokumenteve për aplikim mund të dërgohen në info@ktwopointzero.com deri më 14.03.2019, me titull "HRJ Fellowship Questions".



Projekt i financuar nga BE-ja
dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit
Europian në Kosovë.

Implementuar nga:



Ky Program bashkëfinancohet nga projekti "Mbështetja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë"

financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

V. VLERËSIMI

Një komision i vlerësimit është ngritur nga partnerët implementues dhe dy profesionistë të jashtëm nga fusha e medias dhe gazetarisë, të cilët do të kenë përgjegjësi për vlerësimin e aplikimeve, bazuar në kriteret e specifikuar në Elementet e Programit. Kandidatët e përzgjedhur dhe ata që nuk përzgjedhen do të njoftohen përmes e-mail.

VI. SI TË APLIKOHET

Propozimet për bursë duhet të dërgohen duke përdorur formularin e aplikimit të Kosovo 2.0 për Bursën për gazetari në fushën e të drejtave të njeriut.

Ju lutemi t'i plotësoni të gjitha pjesët e formularit të aplikimit në mënyrë të qartë.

Aplikacioni duhet të dërgohet në shqip, anglisht ose serbisht.

Afati i fundit për aplikim është më 24.03.2019, mesnatë (00:00)

Aplikimet e përfunduara duhet të dërgohen si dosje elektronike në info@ktwopointzero.com me titull "HRJ Fellowship Application",

ose

Përmes postës në adresën:

Kosovo 2.0

Rr. Ferat Dragaj, 60-1

10000 Prishtinë, Kosovë.



Projekt i financuar nga BE-ja
dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit
European në Kosovë.

Implementuar nga:



THE GOVERNMENT
OF THE GRAND DUCHY OF LUXEMBOURG

Ky Program bashkëfinancohet nga projekti 'Mbështetja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë'

financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)